

# UDHËZIME për grumbullimin e diferencuar derë më derë

## MBETURINA ORGANIKE

Mbetje ushqimesh të ftohta nga gatimi, mish i gatuar ose i gjallë, hala peshku, mbetje ose filtra kafeje, çajji dhe kamomili (të ftohta), mbetje frutash dhe perimesh të gjalla ose të gatuara, lëkura, bërtama, bukë.



### SI TË KRYHET GRUMBULLIMI

Futini mbeturinat organike brenda qeseve në Mater-Bi® ose në qese prej letre dhe më pas vendosini ato në bidonin ngjyrë kafe që ju është dorëzuar kohë më parë nga Bashkia,. Në ditën e caktuar për grumbullimin, mbyllni qesen dhe vendoseni në bidonin e posaçëm në rrugë.

### ÇFARË NUK DUHET BËRË:

- Mos i përzieni mbeturinat organike me mbeturinat jo organike si pelena, barna, bateri, shtroja për kafshët shtëpiake
- Mos i vendosni mbeturinat organike në qese plastike
- Mos i vendosni mbeturinat organike në bidona të ndryshëm në krahasim me ata që ju janë dorëzuar

## LETRA, KARTONA DHE TETRAPAK

Gazeta, kuti në tetrapak (si ato të qumështit, të lëngjeve të frutave, të salcës së domateve) të shpëlara mirë dhe të shtypura. Revista, depliant, libra, faqe, fletore, qese letre, kartona të palosur, kartona ambalazhi, kuti për ushqime (makarona, oriz etj.).



### SI TË KRYHET GRUMBULLIMI

Ditën e grumbullimit, vendosni përpara shtëpisë mbeturinat e palosura mirë ose të lidhura në formë pakoje. Mund të vendosen në thasë, çanta prej letre ose në kuti kartoni.

### ÇFARË NUK DUHET BËRË:

- Mos e vendosni letrën në qese plastike ose në kuti të papërshtatshme
- Mos e përzieni letrën me materiale të tjera si plastikë dhe metal, letër të plastifikuar, karton të bashkuar me Material tjetër.

## MBETURINA PLASTIKE

Të gjitha kutitë ose ambalazhet plastike si shishe uji ose lëngjesh, kuti polistiroli të pastruara, flakonë për detergjentë ose prodhime kozmetike të lëngshme, kuti për lëngje, shirita najloni, pjata dhe gota plastike, vazo për lule dhe në përgjithësi ambalazhe dhe kuti me simbole PE, PET, PVC.



### SI TË KRYHET GRUMBULLIMI

Futini mbeturinat në qese plastike gjysmë transparente dhe vendosini përpara shtëpisë ditën e grumbullimit. **Mos përdorni KURRË thasë të zinj ose plotësishë të zbehtë.**

### ÇFARË NUK DUHET BËRË:

- Mos përdorni thasë të zinj
- Mos përzieni plastikën me lugë, pirunj dhe pjata plastike që mund të përdoren vetëm një herë (që duhen hedhur në mbeturinat e thata!), me polistirolin dhe në përgjithësi objektet plastike që nuk janë enë mbajtëse ose ambalazhe (si lodrat ose arkat për fruta dhe perime).

# UDHËZIME për grumbullimin e diferencuar derë më derë

## XHAMİ DHE KANAÇET

Të gjitha enët prej xhami si shishet, gotat, vazot për ushqime etj. Të gjitha enët prej aluminji (si kanaçet përpjje dhe ushqime ose kavanozat) ose prej metali dhe enët me simbolet ACC dhe AL.

**KUJDES:** Kristali, qeramika, pirex, tubot prej neoni dhe llampat për kursimin energjetik ose me led duhet të çohen në një qendër grumbullimi. Edhe llampat normale nuk duhen hedhur midis qelqit por në mbeturinat e thata (duke pasur kujdes që të mos thyhen).



### SI TË KRYHET GRUMBULLIMI

Xhami dhe kanaçet duhe shpëlarë për të hequr mbeturinat e ushqimit.

### ÇFARË NUK DUHET BËRË:

- Mos e përzieni xhamin dhe kanaçet me sende qeramike, porcelani, kristali, tuba neoni, enë me simbolet T dhe F
- Mos e vendosni xhamin dhe kanaçet në qese plastike

## MBETURINAT E THATA

Gomë, CD dhe kuti për CD, shtroja për kafshët e vogla shtëpiake, celofan, lugë, pirunj dhe pjata plastike që përdoren vetëm një herë, lodra, letër me vaj ose e plastifikuar, pelena, peceta higjenike (lines), videokaseta, kaseta audio dhe kutitë e tyre si dhe në përgjithësi të gjitha ato mbeturina që nuk mund të riciklohen dhe që nuk përfshihen në grumbullimin e diferencuar të xhamit, kanaçeve, plastikës, letrës dhe mbeturinave të thata.



### SI TË KRYHET GRUMBULLIMI

Futini mbeturinat e pariciklueshme (mbeturinat e thata) në qese plastike gjysmë transparente në mënyrë që ti nxirri jashtë ditën e caktuar për grumbullimin.

### ÇFARË NUK DUHET BËRË:

- Mos i vendosni mbeturinat e thata brenda thasëve të zinj ose jo transparentë
- Mos i përzieni me materiale të tjera si plastikë, xham, alumin, letër dhe karton, mbetje ushqimore, barna, bateri, mbetje nga krasitja e bimëve, mbeturina të rënda dhe në përgjithësi me sende që mund t' riciklohen dhe përfshihen në grumbullimin e diferencuar. **Nuk mund të përdoren thasët e zinj.**

## QENDRA E GRUMBULLIMIT

Mbeturinat për të cilat nuk parashikohet grumbullimi derë më derë duhen çuar në Qendrën e Grumbullimit. Mbeturinat që mund të çohen në Qendrën e Grumbullimit janë: mbetje vegjetale, (bar, degë, gjethë dhe mbetje nga krasitja), ambalazhe plastike, mbeturina të rënda, veshje të përdorura dhe këpucë, mbetje druri (mobilje, palet, dyer, dritare...), toner (të përdorimit shtëpiak), letër, karton dhe tretrapak, ambalazhe prej xhami, metal dhe ambalazhe metali, bateri makinash (nga përdorues privatë), frigoriferë dhe ngirrës, televizorë, kompjutera dhe pajisje të tjera elektroshtëpiake, vaj vegjetal (kuzhine) dhe vaj mineral (makine), llampa neoni, bojëra dhe ngjyrues me përbërje uji, lavatriçe dhe pjatalarëse. **BATERITË DHE BARNAT E SKADUARA** duhet të hidhen në koshat e posaçëm të vendosur në territorin bashkiak afër farmacive, dyqaneve për shitjen e materialeve elektronike dhe ndërtesave publike.



**NUK MUND TË ÇOHEN NË QENDRËN E GRUMBULLIMIT MBETURINAT SPECIALE TË RREZIKSHME:** në qendrën e grumbullimit mund të çohen vetëm mbeturinat me prejardhje shtëpiake, jo ato që vijnë nga aktivitetet prodhuese, industriale dhe bujqësore.